



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE PRIVAT
ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT
"STRATI" Sh.p.k.




Adresa: Rr."Jordan Misja", P 141/1, Shk 1, Ap 7, Tiranë, Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com
Cel: Gentian Strati: 0674000450; Valter Kaçupi: 0674000456; Kozeta Guri: 0674000455; Edvin Malotaj: 0674000457

Nr. 5419

Nr. 5082 Prot.

Tiranë, më 01.11.2022

Drejtuar : Qendrës Kombëtare të Biznesit



Për dijëni : Shoqërisë "HIDA CONSTRUCTION" Sh.p.k.
Shoqërisë "Cao Standart" Sh.p.k.

Lënda : *Urdhër për vendosjen e sekuestros konservative*

Në Tiranë, sot më datë 01.11.2022,

Unë **Valter Kaçupi**, përmbarues gjyqësor privat pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "Strati" Sh.p.k., me NIPT L21825003E, e pajisur me çertifikatë Nr. 98, Maj 2012 lëshuar nga Ministri i Drejtësisë, pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore, në zbatim të urdhërit të ekzekutimit Nr. 6538, datë 21.07.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,

KONSTATOVA:

Se në datë 11.10.2022 është depozituar kërkesa e palës kreditore dhe lidhur kontrata e shërbimit, pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "Strati" Sh.p.k., për ekzekutimin e titullit ekzekutiv Faturat tatimore të shitjes, Nr. 40, datë 15.06.2019, Nr. 136, datë 01.07.2019 dhe Nr. 194, datë 15.08.2019 lëshuar nga Shitësi Shoqëria "CAO Standart" Sh.p.k, për Blerësin Shoqëria "Hida Construction" Sh.p.k., për të cilat është lëshuar urdhëri i ekzekutimit Nr. 6538, datë 21.07.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë:

Kreditor : Shoqëria "Cao Standart" Sh.p.k.

Debitor : Shoqëria "HIDA CONSTRUCTION" Sh.p.k.

Me Objekt : *pagim fature*

Me vendimin Nr.6538, datë 21.07.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur:

"Pranimin e kërkesës.

Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv për faturat tatimore të shitjes me:

Nr. 40, Nr. Serial 60677791, datë 15.06.2019;

Nr.136, Nr. Serial 71133641, datë 01.07.2019;

Nr.194, Nr. Serial 71133699, datë 15.08.2019, lëshuar nga kreditori Shoqëria CAO STANDART Sh.p.k., kundrejt debitorit HIDA CONSTRUCTION Sh.p.k., për ekzekutimin e detyrimit në vlerën 378.000 Lekë, si dhe kamatëvonesat mbi këtë shumë të llogaritura sipas ligjit Nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare".

Ngarkohet shërbimi përmbarimor të bëjë ekzekutimin e këtij titulli ekzekutiv."

Në zbatim të titullit ekzekutiv palës debitore i është komunikuar shkresërisht lajmërimi për ekzekutim vullnetar.

Sa më sipër bazuar në 527, e vijues të K.Pr.Civile, Ligjit Ligjit Nr. 26/2019 datë 08.05.2019 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat", dhe Udhëzimit "Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor privat",

URDHËROJ:

- 1- Vendosijen e masës së sekuestros konservative në aktivet që zotëron pala debitore të regjistruara pranë jush:
 - **Shoqëria "HIDA CONSTRUCTION" Sh.p.k., me Nipt L72022031A** për ekzekutimin e vendimit Nr. 6538, datë 21.07.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 2- Qendra Kombëtare e Biznesit të bëjë veprimet përkatëse duke ndaluar çdo veprim tjetërsimi apo disponimi mbi aktivet e palëve debitore.
- 3- Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
- 4- Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen sipas dispozitave të Kodit Penal dhe K.Pr.Civile.
- 5- Ky urdhër mbahet në disa kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në Gjykatë brenda 5 ditëve.

Përmbarues Gjyqësor Privat



NIPT: L21825003E

Certifikatë për ushtrim veprimtarie Nr: 26; Nr. 98; Nr. 83; Nr. 106
LN-5367-06-2012